

Vore, më _____.____.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sherbimi i Pastrimit dhe largimit te mbeturinave per Bashkine Vore” Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar - me afat 36 muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **273.460.221 (Dyqind e shatedhjete e tre milion e katerqinde gjashtedhjte mije e dyqind e njezet e nje) leke pa tvsh.**

Financimi per Vitin (2022) eshte 91,153,407 pa tvsh

Financimi per Vitin (2023) eshte 91,153,407 pa tvsh

Financimi per Vitin (2024) eshte 91,153,407 pa tvsh

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkise viti 2022 i miratuar dhe programit buxhetor Afatmesem 2022 - 2024 te Bashkise Vore”.

Procedura e prokurimit do te jete e llojit **Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar - me afat 36 muaj** mbeshtetur ne nenin 42 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe sipas nenin 47, e VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Sa me siper duke qene se shërbimi i pastrimit, **grumbullimit dhe largimi i mbetjeve urbane** është kontratë komplekse, që kërkon financim shumëvjeçar, e cila nuk mund të zbatohet brenda vitit buxhetor dhe ku financimi i saj është i garantuar, Autoriteti Kontraktor ka vendosur kryerjen me afat 36 muaj të shërbimit me objekt: **“Sherbimi i Pastrimit dhe largimit te mbeturinave per Bashkine Vore“.**

Eshte gjykuar e arsyeshme aplikimi i kontrates shumëvjeçare, duke qene se në rastin konkret kontrata shumëvjeçare garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtesinë e realizimit ne kohë të shërbimit, si dhe qendrueshmeri ne kryerjen me cilësi te shërbimit.

Gjykohet e arsyeshme dhe e argumentuar se lidhja e një kontrate shumëvjeçare, rrit efikasitetin dhe shmang vonesat apo mos ofrimin në kohe të këtij shërbimi ndaj qytetarëve, të cilat mund të vijne për shkak të ndryshme objektivë që nuk varen nga autoriteti kontraktor, nderkohe që domosdoshmeria për këto shërbime është me rëndësi shumë të madhe për komunitetin, duke marrë në konsideratë faktin që ky shërbim përbën interes publik të rëndësishëm së veçantë, me karakter të përditshëm dhe të vazhdueshëm.

Kërkesat e autoritetit kontraktor Bashkia Vore, janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeve urbane).

Kontratat shumëvjeçare krijojnë një raport me të mirë ndërmjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomikë për të ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontrates e konkretisht **273 460 221 (dyqind e shatedhjetë e tre milion e katerqinde gjashtedhjetë mijë e dyqind e njetzet e nje)** leke pa tvsh. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën*”, “*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marre ne konsiderate numrin e operatoreve ekonomik qe ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e meparshme nga AK Bashkia Vore dhe Autoritete te tjera kontraktore kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për ketë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **273 460 221 (dyqind e shatedhjetë e tre milion e katerqinde gjashtedhjetë mijë e dyqind e njezet e nje)** leke pa tvsh qe eshte sa vlera e fondit limit dhe vendosja e ketij limiti nuk kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike pasi duke pare edhe eksperiencat e meparshme ata mund te ofertojne si bashkim operatoresh.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e

përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe konkretisht **109 384 088** (Njëqind e nentemilion e tre qinde tetedhjet e kater mijë e tetedhjetet) Leke

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me: a) faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara; b) vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4. "ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të

jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është vlera kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **109 384 088** (Njëqind e nentemilion e tre qinde tetedhjet e kater mije e tetedhjetet) Leke përbën nivelin maksimal prej 40% të përvojes së mëparshme që lejon LPP, duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Vlera prej 40% nuk kufizon aspak konkurrencën dhe është vendosur duke patur parasysh eksperiencat e mëparshme të AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit , QKB për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.2** është përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ””*Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi licenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane

- 2.3.3.** Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001:2015 *Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.
- 2.3.4.** Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 *Sistemet e Menaxhimit Mjedisor* (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.3** e **2.3.4** është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe të mjedisit janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri I mesipër për paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

- 2.3.5.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit **Bashkine Vore**, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
- a) Diplomë
 - b) CV përkatëse
 - c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Drejtuksi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij , është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV perkatëse të tij.

Kriteri i mesiperm për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik për të paktën 3(tre) muajt e fundit si me poshte:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV
- Listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuara nga organet tatimore për të paktën 3(tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme **2.3.6 pika 2** është përcaktuar bazuar në piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencen. Është vendosur periudha prej 3(tre) muajsh pasi konsiderohet e mjaftueshme që ofertuesi të vertetojë që ka një vazhdimësi në aktivitetin e perditshem dhe angazhimin e strukture së stafit drejtues.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të shoqëruar me kontratë individuale të punës të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. *Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë".*

Kriteri konsiderohet i përbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme **2.3.7** është përcaktuar bazuar në piken 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”* dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" dhe është ne perputhje te plote,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj specialisti.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë fuqi punëtore për realizimin e kontrates prej minimalisht **43 (dyzet e tre) persona** për 3(tre) muajt e fundit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Listëpagesen e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhura nga punësimi të konfirmuar nga organet tatimore për 3(tre) muajt e fundit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumenti i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 43 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për

kohen e punes ne muaj per punonjes. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Eshte vendosur qe numri i punonjesve ne dispozicion te operatorit ekonomik per realizimin e kontrates te jete minimalisht 43 punonjes per 3(tre) muajt e fundit pasi kjo kërkesë lidhet me domodoshmërinë për realizimin e objektit të prokurimit, është në një numër të justifikuar dhe për një periudhë kohore të mëparshme prej 3(tre) muajsh por që i shërben vetëm objektit konkret.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Nr	Specialiteti	Njesi	Sasi
1	Shofere	persona	5
2	Puntor makine per grumbullim mbeturina	persona	16
3	Puntor per fshirje manuale	persona	14
4	Shofer per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve	persona	1
5	Punetore per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve	persona	2
6	Drejtor teknik per kontraten	persona	1
7	Shofer per larjen e rrugeve	persona	1
8	Personi i zyles se kontaktit	persona	1
9	Specialist, monitorues terreni	persona	2
	Shuma		43

1-Shoferi persona 4(Kater). Meqe ne specifikime kemi kerkuar nga 4 mjete transporti pra duhen **4 shofera**, plus nje shofer per kamioncinen e cila miremban VGM ne total duhen 5 shofera.

2-Puntor makine per grumbullim mbeturina persona 12 (dymbedhete). Ne normativat e mjeteve te transportit çdo mjeti inevojiten 3 punetore qe bejne vendosjen e kontenierit ne mjet pastrimin e vendit dhe shkarkimin e mbeturinave ne mjet. Meqe jane kerkuar 4 mjete numri i puntoreve qe duhen eshte 12 (dymbedhete). i shtojme edhe 4 punetore te kamioncines ne total dote duhen 16 punetore.

3-Punetore per fshirje manuale jane kerkuar 14 (katermbedhjet).

4- Puntor per Mirembajtja e VGM gjate dites dhe grumbullimi i mbetjeve ndertimore dhe te vellimshme. Nje shofer per kamioncinen dhe 4 punetore

5- Shofer per mjetin e Larjes se Kazaneve 1 (nje)

6-Punetore per larjen dhe dizinfektimin e konteniereve 2 (dy)

7-Shofer per mjetin e larjes se rrugeve 1 (nje)

8-Personi i zyres se kontaktit, monitoruesit e terrenit jane persona pjese te stafit te kontraktorit qe bazuar ne specifikimet teknike do sherbejne ne zyren per mardheniet per publikun si dhe do te monitorojne per llogari te kontraktorit dhe do te sherbejne edhe si pike kontakti zbatimin ne terren te kontrates.

Specialist , monitorues terreni, Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë dhe Drejtor teknik per kontraten.

2.3.9 Operatori ekonomik per produktin dezinfektues te konteniereve duhet te paraqese autorizim prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar i prodhuesit, shoqëruar me kontrate ose dokument angazhimi midis prodhuesit dhe distributorit

Argumentimi: *Gjatë hartimit të kriterëve të vecanta të vlerësimit ka vendosur si kriter autorizim/ nga prodhuesi / distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë produkt në këtë procedurë prokurimi, bazuar ne pikën 1/c të nenit 77 të LPP dhe në nenet 39 dhe 40 te VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar, AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e mallit që do të përdoret për nga vetë rendesia që ka ky sherbim.*

Kerkesa e ketij dokumenti qe ne kete faze krijon nje lehtesi per Autoritetin Kontraktor, pasi ne kete menyre siguron cilesine. Nuk kane qene te pakta rastet ku OE gjate zbatimit te kontrates nuk kane respektuar standartet dhe specifikimet teknike. Nepermjet dorezimit te ketij dokumentacioni qe ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimet qe gjate zbatimit te perdor te njejtin mall. Per t'u theksuar ne vijim te sa me siper cituam, ky kriter eshte vendosur i tille me qellim verifikimin e permbushjes se specifikimeve teknike te produktit qe do te perdori OE.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, jo më pak se **3 (tre) copë**.
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 deri 4 ton jo më pak se **1 (nje) copë**;

- c) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 0.5 deri 1.5 ton jo më pak se **1 (nje) copë**;
- d) Makinë transportuese kamioncine per transportin e mbetjeve te vellimshme me kapacitet mbajtes 2 der 4 ton veteshkarkuese jo me pak se **1 (një) copë**;
- e) Makinë teknologjike me paisje te vecante per larjen e konteniereve **1 (nje) copë**;
- f) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes 7 deri ne 8 ton, jo më pak se **1 (një) copë**;

Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën **2.3.10**, gërma *a – f*, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruar në pronësi qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Per mjetet e deklaruar me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) , leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqese kontraten e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Për mjetet në pronësi/qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor ka te drejten me ose pa paralajmerim paraprak, perpara shpalljes se fituesit, të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruar në procedurën e prokurimit, si dhe te deklarojë adresen e sakte te vendndodhjes se mjeteve në Shqipëri, me qellim verifikimin e tyre. Në rast se mjetet e deklaruar nga Operatorit ekonomik nuk rezultojne te njejta me ato qe do te kontrolloje AK, Operatori Ekonomik do të s’kualifikohet.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetic më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimeve ligjore në Kodin Civil.

1-Mjet teknologjik pastrimi jo me pak se 10 ton. Sasia e mbeturinave që grumbullohen në ditë është **39 ton** ose 4 rruge në ditë. Janë kërkuar 2 mjete të cilët punojnë për të evaduar të gjithë sasinë e mbetjeve ditore.

2-Mjet teknologjik pastrimi 3 deri 4 ton dhe 0.5 deri 1.5 ton cope 2. Janë kërkuar për grumbullimin e mbeturinave në rrugë të ngushta (derrë me derrë) ku nuk ka mundësi të futet mjete me kapacitet 10 ton.

3- Kamioncine 2 deri 4 ton, vetshkarkuese për mirëmbajtjen e VGM gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve ndërtimore dhe të vëllimshme.

4- Makinë teknologjike me paisje të vecante për larjen e konteniereve. Ky mjet shërben për larjen e konteniervë në vend pa u transportuar në autopark. Paisja e vecante konsiston në sprucatore të ujit dhe dizinfektantit si dhe Vasken e mbetjeve që dalin nga larja e kontenierit.

5-Makinë lagje dhe larje rrugësh cope 1. Sipërfaqja e rrugës që do të laget në vit **28068 m2 në ditë.**

6-Mjet teknologjik pastrimi reserve 10 ton. Ky mjet nevojitet për zëvendësim në rast se është me defekt ndonjë mjet.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit